VENDIM
Nr. 33, datë 18.7.2016

PËR LICENCIMIN SHA UJËSJELLËS BULQIZË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit sh.a. Ujësjellës Bulqizë, me:
   Drejtues ligjor: Nedion Muça
   Drejtues teknik : Fisnik Hyseni
2. Operatori sh.a. Ujësjellës Bulqizë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
   Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Bulqizë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë dyvjeçare deri në datën 17.7.2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani